


**Tryeza e rrumbullakët me temë: “Konsultim publik mbi projektligjin ‘Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’, organizuar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës**

*Kushtetuta e RSh ka parashikuar të drejtën e 20000 zgjedhësve për të propozuar një ligj në Kuvend, por nuk ka një rregullim të sistematizuar të procedurave përkatëse, ndërkohë që ato duhet të parashikohen me ligj. Deri më sot kemi pasur pak nisma të tilla dhe vetëm njëra prej tyre është kurorëzuar me miratimin në Parlament të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Ligj nr. 9669, dt. 18.12.2006). Në këto përvoja është evidentuar qartë nevoja e krijimit të kuadrit të përshtatshëm ligjor për ndërmarrjen dhe ushtrimin e kësaj nisme. Aktualisht, në demokracitë evropiane po kërkohet rritja e parashikimeve ligjore për të garantuar këto të drejta.*

Në kuadër të projektit **“Zbatimi dhe forcimi i nismave ligjvënëse qytetare të parashikuara në Kushtetutë, përmes përmirësimeve ligjore dhe rritjes së aktivizmit të shoqërisë civile”**, të mbështetur dhe financuar nga Fondacioni Soros, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare organizoi më 10 Nëntor 2016, pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, tryezën e rrumbullakët me temë: **“Konsultim publik mbi projektligjin ‘Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’**”. Në tryezë morën pjesë 63 pjesëmarrës, pjesë e stafit akademik, studentë dhe bashkëpunëtorë pranë këtij universiteti.

Temat e trajtuara nga organizatorët tërhoqën vëmendjen e pjesëmarrësve, pasi ky projektligj afirmon rëndësinë e iniciativës ligjvënëse të shtetasve në RSH për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe ofrimin e garancive dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri e të pavarësisë institucionale. Kjo tryezë u mirëprit nga pjesëmarrësit të cilët pasi u njohën me risitë e këtij projekt ligji, u bënë pjesë e diskutimeve. Ata nxorën në pah rëndësinë që ka kjo nismë për të bërë të mundur që zëri i grupeve të interesit, i shoqërisë civile dhe i çdo qytetari.

Diskutimi vijoi më tej me sqarime konkrete në lidhje me mënyrën se si do të realizohej kjo iniciativë, institucionet përgjegjëse dhe mënyra se si qytetarët do të mund të ndërhyjnë në projekt ligjin/nismën/projekt idenë e tyre deri në kalimin e tij/saj në parlament dhe hyrjen e tij në fuqi. Konkluzionet e tryezës do të bëhen pjesë e përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit.



*Foto nga tryeza e rrumbullakët me temë: “**Konsultim publik mbi projektligjin 'Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë**”, organizuar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, më 10 Nëntor 2016.*